



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI
ADRESA NR.3, HOXHA TASIM,
NR.292
TEL: 695761243

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4871

Nr. koleksioni: 1691

Tirane më 29/07/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2022052730183823141

REPUBLIC
OF THE
PHILIPPINES





A2022052730183823141

MARRËVESHJE PËR BLERJEN E KUOTAVE

("Marreveshja")

Sot, me dt. 29.07.2022, para meje noteres Valbona Selimi, notere ne Tirane, ne zyrën time me seli ne Prugen Hoxha Tahsim, nr. 292, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

Znj. Xhenis Xhabafti, e bija e Arbenit, e datelindjes 25.05.1995, lindur ne Tirane, banuese ne Tirane, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me pasparten nr. BF9995679, me nr. Personal J55525072W, më tej referuar sebashku si "**Blerese**",

dhe

Ermelinda Jasini, atësia Eqerem, amësia Nazmije, shtetase Shqiptare, lindur në Cerrik, Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Isa Boletini; Nd. 21; H. 20; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1017; Tiranë, lindur më 16/04/1989, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 029964451 dhe nr. personal I95416083P, me tej referuar si "**Shitesi**".

HYRJE

- A. Shitesi eshte ortake te Shoqërisë "HPG Energy" sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi (NUIS) **L81603016R**, e organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, me adresë ne TIRANE Njesia Administrative Nr.5, Rruga Nikolla Tupe, Pallati 1, Ap.9, Kodi Postar 1019, (më tej referuar si "**Shoqëria**"), ku Shitesi zoteron 50% dhe Znj. Xhenis Xhabafti zoteron 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- B. Blerësi dëshiron të blejë nga Shitesi dhe Shitesi dëshiron t'i shesin Blerësit, kuoten që Shitesi zoteron;
- C. Per sa me siper, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të angazhimit të tyre respektiv për shitjen dhe blerjen e kuotave.

PALET BIET DAKORD SA VIJON:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Termat me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

"**Barrë**" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individi (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi per te blere ne te ardhmen apo te drejte parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigurues (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajte te drejte ose cdo marrveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër barresues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjetër per pagim me rezerve;

"**Qendra Kombëtare e Biznesit**" nënkupton organin publik Shqiptar që ka kompetencën e regjistrimit në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

Fq. 1



A2022052730183823141

2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

2.1 Shitja e Kuotave

2.1.1 Ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete Marrëveshje Shitësit shesin duke kaluar në pronësi të plotë të Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësit perqindjet si me poshte të kapitalit të regjistruar te Shoqërisë:

(i) Znj. Xhenis Xhabafti blen nga Shitesja 50 % të kapitalit të Shoqërisë.

Si rrjedhoje e kesaj shitje Bleresi zoteron 100% te kapitalit te Shoqerise.

2.1.2 Transferimi i kuotave bëhet në përputhje me kete Marreveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

2.1.3 Titulli i pronesise mbi kuotat transferohet tek Blerësi ne momentin e lidhjes se kesaj marreveshje. Kuotat shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe perfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri ne daten e kalimit te ponesise mbi kuoten (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin, shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri me sot), të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre

2.2 Cmimi i Blerjes

Blerësi i paguan Shitëses per blerjen si me siper shumen totale prej 5000 leke.

2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

Palet deklarojne se pagesa e cmimit te blerjes eshte shlyer rregullisht mes paleve.

2.4 Vendimi i Ortakut

Shitesit deklarojne se e miratojne kete shitje kuotash dhe se kete miratim e reflektojne ne vendimin e ortakut te Shoqerise qe vendos mbi miratimin e transferimit të Kuotes nga Shitësit tek Blerësi.

3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet

3.1.1 Kjo Marrëveshje zhvleftëson cdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.

3.1.2 Cdo ndryshim i kësaj Marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshje.

3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

3.3 Regjistrimi i Marreveshjes

Palet bien dakort se regjistrimi i Marreveshjes ne Qendren Kombëtare te Biznesit do te behet nga Bleresi brenda nje afati 15 ditor.

Fq. 1



4.

LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

* * *

Akti u redaktua konform vullnetit të plote të paleve të cileve pasi ua lexova marrëveshjen dhe pasi deklaruan se u kuptua prej tyre, e nenshkruan rregullisht para meje noteres dhe une Noterja verifikoj nenshkrimin e tyre konform Ligjit.



Xhenis Xhabafti

Xhenis Xhabafti

Ermelinda Jasini

Ermelinda Jasini

Palet

Noter Valbona Selimi

Valbona Selimi